




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

Kaçanik
22 Gusht 2023
Nr. 01 104/02-12471

Raporti

Ky raport është përgatitur duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në komuna me theks neni 5. Zbatimi i standardeve të konsultimit publik dhe neni 17 Mbledhja e komenteve, komunikimi dhe adresimi i tyre.

Takimet

Me të pranuar Draft dokumentin : Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) 2024-2026, Drejtorja e Financave dhe Buxhetit ka zhvilluar disa takime me Kryetarin Besim Ilazi si dhe me ekzekutivin komunal, dhe pas hartimit të Draft Dokumentit, i njejt i është përcjellë zyrës së informimit për publikim dhe në të njëjtën kohë është publikuar edhe njoftimi për mbajtjen e Konsultimit Publik.

Publikimi në uebfaqen zyrtare të Komunës

-Me **24.05.2023**, është publikuar njoftimi për mbajtjen e konsultimit për : Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) 2023-2025 Njoftimi është publikuar në uebfaqen zyrtare të komunës, facebookun e komunës.

Publikimi në uebfaqe: Njoftimi dhe draft dokumenti:

<https://kk.rks-gov.net/kacanik/wp-content/uploads/sites/14/2023/05/12471.pdf>

1.

Publikimi facebook:

<https://www.facebook.com/KomunaKacanik>

-Me 07.06.2023, është mbajtur konsultimi publik me qytetarë, në këtë konsultim të pranishëm kanë qenë , qytetarë dhe janë dhënë edhe komentet.

Lajmi për mbajtjen e konsultimit publik është publikuar në këtë vegëz:

<https://kk.rks-gov.net/kacanik/news/mbahet-konsultim-publik-me-teme-korniza-afatmesme-buxhetore-kab-2024-2026/>

, lajmi është publikuar edhe në facebookun e komunës:

<https://www.facebook.com/KomunaKacanik>

Komentet:

Nexhmedin Lika: Kryetar i fshatit Shtrazë

Kërkoj asfaltimin e një rruge 150 m në Shtrazë.

-Përmes kontratës “Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve lokale”, bazuar ne prioritetet e komunës parashihen të asfaltohen rrugicat e ndryshme ne fshatra.

Rrustem Zenuni- Asambleist komunal: Korniza buxhetore ka investime edhe në turizëm, ju përgëzoj, kërkoj investime dhe fokus edhe tek zonat komunale ekonomike, rregullim te infrastrukturës rrugore, ujësjellës e kanalizim. Ju përgëzoj për planifikimin e ndërtimit të çerdhes në Kaçanik të Vjetër, të planifikohet rregullimi i çerdheve edhe ne Doganaj, Elezaj etj. Ju përgëzoj poashtu për planifikimin e rrugës për te Kulla e Hasanit . Kërkoj rregullim të terreneve sportive në Duraj, ku është hapësira e gatshme.

- Rregullimi i terenit sportiv në fshatin Duraj, ku është hapësira publike, do të shqyrtohet të realizohet në kuadër të projektit “rregullimi i parqeve dhe hapësirave publike” në vitet vijuese buxhetore ose përmes planifikimeve të drejtorisë së arsimit.

Naser Murseli- Kryetar- Këshilli i fshatit Doganaj+Koxhaj (zona8)

Prioritet trotuari prej Fushës së Pajtimit deri te Pishina Medi dhe tek Ura e “Barovinës”,
-Ky projekt është i koduar ne projektbuxhetin e viti 2024-2025

Asfaltimi i rrugës “ Fari Demnika”, dhe rregullimi i përroskës tek varrezat

-Përmes kontratës “Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve lokale”, bazuar ne prioritetet e komunës parashihet te asfaltohet rruga “Flakadanët”-Soponicë në këtë vit. Kurse rregullimi i përroskës parashihet ne kuadër te projektit “Rregullimi i shtretërve te përroskave”-projekt i koduar ne DUKMM

Hasip Salihu- Kryetar- Bajnicë + Semajë (zona 12)

Rregullimi i rrugës që lidh fshatin Semajë dhe Komunën e Ferizajt, si dhe investime në renovimin e objektit dhe sistemit te ngrohjes të Kompanisë “ **Pastërtia**”.

- **Projekti i rrugës alternative te fshatit Semaje qe lidhen e me fshatin Gaçke-Ferizaj është i koduar ne projektbuxhetin e vitit 2024 në kuadër te projekteve ndër komunale.**

Kadri Dardhishta-Kryetar- Kaçanik- Këshilli i qendrës urbane, zona I

Rregullim të rrugës “ Avdurrahim Shehu”

-Sanimi i dëmtimeve në rrugët lokale kryhen përmes kontratës “Mirëmbajtja e rrugëve lokale”

Rruga “ Kjani Bela” është bërë zgjerimi, por është rrugë e dëmtuar

Sanimi i dëmtimeve ne rrugët lokale kryhen përmes kontratës “Mirëmbajtja e rrugëve lokale”

Fatmir Bunjaku – asamleist komunal

Të bëhet rregullimi i rekës që lidh fshatin Biqec me fshatin Nikaj

-rregullimi i përroskave parashihet ne kuadër te projektit “Rregullimi i shtreterve te përroskave”-projekt i koduar ne DUKMM

Fadil Vishi- Kryetar Këshilli i Fshatit Dubravë

Falënderues për projektet e realizuara, kërkoj që të bëhet rregullimi i trotuarit nga Lumi Lepenc deri tek varrezat e dëshmorëve, rregullimi i rekës së fshatit, një kënd rekreativ për pushues, zgjerim të rrugës “ Fetije Qorri”.

-Vazhdimi i trotuarit ne rrugën “Beteja e 25 Majit” do te shqyrtohet ne kuadër te planifikimeve te ardhshme te ekzekutivit dhe arsyeshmërisë se projektit.

- Rregullimi i përroskave parashihet ne kuadër te projektit “Rregullimi i shtreterve te përroskave”-projekt i koduar ne DUKMM

- Rregullimi hapësirave publike, do te shqyrtohet te realizohet ne kuadër te projektit “rregullimi i parqeve dhe hapësirave publike” ne vitet vijuese buxhetore
- Permes kontratës “Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve lokale”, bazuar ne prioritetet e komunës do te shqyrtohet edhe zgjerimi i rrugës “Fetije Qorri”

Bashkim Krasniqi- asambleist- fshati Kaçanik i Vjetër është i vetmi fshat që në vazhdimësi mbi popullohet, andaj edhe investimet janë të nevojshme. Të rregullohet shtrati i Lumit Nerodime, së paku tek stacioni i trenit, rregullimi i disa rrugicave.

- Ndërtimi i shtretërve te lumenjve është parapare ne kuadër te projektit të koduar te DUKMM-ja “Ndërtimi i shtretërve te lumenjve dhe përroskave” por kostoja e këtyre projekteve kalon mundësitë buxhetore te komunës,
- Përmes kontratës “Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve lokale”, bazuar ne prioritetet e komunës parashihet te rregullohen shumica e rrugicave te fshatrave dhe zonës urbane

Shaban Dubova-qytetar kërkoj rregullim të infrastrukturës në Fshatin Dërnagllavë.

- Përmes kontratës “Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve lokale”, bazuar ne prioritetet e komunës parashihet te rregullohen shumica e rrugicave te fshatrave dhe zonës urbane

Besnik Dema-Kryetar- Këshilli i fshatit Bob (zona 3)

Te bëhet rregullimi i kanalizimit(në lagjen Kuka).

- Ky projekt është ne prioritetet e drejtorisë se shërbimeve publike dhe do te realizohet përmes kontratës aktive “Ndërtimi i kanalizimeve fekale dhe atmosferike”

Te bëhet rregullimi i Prrockes nga shkolla e deri te shtëpia e fundit

- Rregullimi i përroskave parashihet ne kuadër te projektit “Rregullimi i shtretërve te përroskave”-projekt i koduar ne DUKMM-

.Te filloj vazhdimi i përroskës aty ku ka mbet e deri shtëpia e fundit (në lagjen Zeneli).

- Rregullimi i përroskave parashihet ne kuadër te projektit “Rregullimi i shtretërve te përroskave”-projekt i koduar ne DUKMM

Te bëhet rregullimi i Kubëzave te betonit(në lagjen Çaka)

- Sanimi i dëmtimeve ne rrugët lokale kryhen permes kontratës “Mirëmbajtja e rrugëve lokale”

Fitore Vishi- asmableiste

Kërkoj të bëhet zgjerimi i rrugës tek shkolla fillore e fshatit Runjevë, pastrimi i lumit Nerodime, të rregullohet rrua e lagjes “ Miftar”.

- Përmes kontratës “Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve lokale”, bazuar në prioritetet e komunës parashihet të rregullohen shumica e rrugicave të fshatrave dhe zonës urbane
- Pastrimi i lumit Neodime është aktivitet i vazhdueshëm dhe intervenohet për çdo vit. Edhe në vitin 2023 kemi bërë pastrimin e lumit Nerodime në segmentin nga Xhamia e Dëshmoreve deri te Ura e Konakut.

Ziber Luma Kryetar- Këshilli i fshatit Gllloboqicë (zona 20)

Kërkojmë rregullimin e një fushe sportive.

- Rregullimi i terrenit sportiv në fshatin Gllloboqice, ku është hapësira publike, do të shqyrtohet të realizohet në kuadër të projekteve përmes planifikimeve të drejtorisë së arsimit dhe drejtorisë së kulturës.

Azem Koraqi-Kryetar - Këshilli i fshatit Kovaqec (zona 14)

Kërkojmë rregullimin e përroskës në fshatin Kovaqec, kërkojmë bashkëfinancim edhe me komunën, si dhe intervenim në rregullimin e kanalizimit në disa shtëpi.

- Rregullimi i përroskave parashihet në kuadër të projektit “Rregullimi i shtretërve të përroskave”-projekt i koduar në DUKMM,
-
- Projektet e kanalizimeve janë në prioritetet e drejtorisë së shërbimeve publike dhe do të realizohen përmes kontratës aktive “Ndërtimi i kanalizimeve fekale dhe atmosferike”

Bahri Selimi

Drejtor për Buxhet dhe Financa



Kryesues i Grupit Punues